REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:166561

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05265570

C.nr.1305/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: E.S, F.Sh, F.J., F.A. dhe J.K. nga M, të cilin sipas autorizimit i përfaqëson I.Xh avokate ne S, me adresë rr. "M.N", kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës–Drejtoria Komunale e Arsimit, lidhur me çështjen kontestuese kompensimi i shtesave në pagë-inflacion, jashtë seancës gjyqësore konform nenit 398 dhe 399 të LPK-së, me datë 31.01.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve E.S, F.Sh, F.J. dhe F.A. nga M, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë, në emër të kompensimit te shtesave ne page-inflacionit ti kompensoj si në vijim:

- Paditësit E.S, në emër të kompensimit të shtesave në page-inflacion për periudhën kohore prej 01.09.2021 deri 22.11.2022, gjithsej shumën në lartësi prej 380.13€;
- Paditësit F.Sh në emër të kompensimit te shtesave ne page-inflacion për periudhën kohore prej 16.08.2019 deri 22.11.2022, gjithsej shumën në lartësi prej 771.74€;
- Paditësit F.J. në emër të kompensimit te shtesave ne page-inflacion për periudhën kohore prej 16.08.2019 deri 22.11.2022, gjithsej shumën në lartësi prej 443.68€;
- Paditëses F.A. në emër të kompensimit te shtesave ne page-inflacion për periudhën kohore prej 02.11.2020 deri 22.11.2022, gjithsej shumën në lartësi prej 819.63€;
- Paditësit J.K. në emër të kompensimit te shtesave ne page-inflacion për periudhën kohore prej 16.08.2019 deri 22.11.2022, gjithsej shumën në lartësi prej 501.88€;

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 16.08.2022, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II.REFUZOHET PJESËRISHT si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve sa i përket kërkesës për kompensimin e shtesave ne page-inflacion si ne vijim:

- Paditësit E.S për periudhën kohore 01.01.2018 e deri me 01.09.2021 dhe 23.11.2022 e deri me 31.12.2022 apo shumën prej 235.83€;

2022:166562

- Paditësi F.Sh për periudhën kohore 01.01.2018 e deri me 15.08.2019 dhe 23.11.2022 e deri me 31.12.2022 apo shumën prej 188.26€;

- Paditësit F.J për periudhën kohore 01.01.2018 e deri me 15.08.2019 dhe 23.11.2022 e deri me 31.12.2022 apo shumën prej 107.23€;

- Paditëses F.A. për periudhën kohore 01.01.2018 e deri me 15.08.2019 dhe 23.11.2022 e deri me 31.12.2022 apo shumën prej 290.55€;

- Paditësit J.K. për periudhën kohore prej kohore 01.12.2018 e deri me 15.08.2019 dhe 23.11.2022 e deri me 31.12.2022 apo shumën prej 120.16€

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 16.08.2022, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III.OBLIGOHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia kompensoj paditëses shumën në lartësi prej 312.00 euro (treqind e dymbëdhjetë euro), në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate, me datë 16.08.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i shtesave në pagë-inflacion.

Në padi ka theksuar se paditësit janë te punësuar pranë SHFMU"T" në Mitrovicë si mësimdhënës dhe punëtorë teknik në Institucionin e lartcekur. Tutje e njëjta ka theksuar se paditësve nuk i'u është bërë kompensimi i shtesave ne page-inflacion edhe pse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, e njëjta përmes parashtresës se datës 20.12.2023 ka bërë precizimin e kërkesë padisë duke u tërhequr nga kërkesa për kompensim e inflacion ne page për vitin 2017 dhe ka zgjeruar kërkesë padinë për kompensimin për inflacion për vitin 2018,2019,2020,2021 dhe 2022, për paditësin E.S shumen prej 616.80 euro, për paditësin F.Sh shumen prej 960.20 euro, për paditësin F.J. shumen prej 551.00 euro, për paditësen F.A. shumen prej 1.111.25 euro si dhe për paditësin J.K. shumen prej 622.05 te gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data 16.08.2022, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar

E paditura në përgjigjen në padi e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve dhe kërkon që e njëjta të hedhet poshtë si e pa lejuar pasi qe te njëjtit kanë kërkuar kompensim ne emër te shtesave ne pagë për shkak te inflacionit, për periudhën kohore janar 2017,2018,2019,2020,2021,ndersa padinë e kane paraqitur me datën 16.08.2023 megjithatë duke pasur parasysh afatin e parashkrimit te përcaktuar me ane te nenit 87 te Ligjit te Punës,

paditësit kane mundur te kërkojnë kompensimin ne emër te inflacionit ne page vetëm periudhën kohore nga data 16.08.2019 e tutje duke pasur parasysh edhe faktin tjetër qe Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2021 është shkëputur me 21 nëntor te viti 2022 përmes njoftimit 01B/488 te Ministrisë se Arsimit dhe për pasoje qe nga ky muaj nuk ka prodhuar me efekte juridike. Duke pasur parasysh se Kontrata Kolektive asnjëherë nuk ka qene nënshkruar asnjëherë nga ana e Mistrisë se Financave dhe nuk është ndarë asnjë buxhet për zbatimin e detyrimeve me implikime financiare te cilat janë paraparë me Kontratën Kolektive te Arsimit dhe si rrjedhojë e mungesës se mjeteve buxhetore është i pamundur realizimi i kërkesave te paditëses. Andaj ne baze te lartcekurave kërkojmë nga gjykata qe te refuzoj ne tërësi si te pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe njëherit te obligoj paditësi qe ti paguaj te gjitha shpenzimet e krijuara procedurale.
Andaj, bazuar në këto fakte i ka propozuar gjykatës, që padinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8, 398 dhe 399 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi, nga provat e bashkangjitura padisë dhe atë për:

Paditësin E.S

Nga kontrata e punës e lidhur ne mes paditësit dhe te paditurës vërtetohet fakti se paditësi ka filluar punën me datën 01.09.2021 tek e paditura.
Nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësi ka realizuar page mujore ne lartësi prej 361.85 euro kurse kompensimin e ka kërkuar për pagën 270.51 euro. Ndërsa nga indeksi i harmonizuar çmimeve te konsumit konstatohen ndryshimet mujore dhe vjetore te çmimeve ne përqindje: për vitin 2021 është 3.4%, ndërsa për vitin 2022 është 11.6%.

Paditësin F.Sh

Nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar page mujore ne lartësi prej 472.25 euro kurse kompensimin e ka kërkuar për pagën 421.20euro. Ndërsa nga indeksi i harmonizuar çmimeve te konsumit konstatohen ndryshimet mujore dhe vjetore te çmimeve ne përqindje: inflacioni për vitin 2019 është 2.7, për vitin 2020 është 0.2%, për vitin 2021 është 3.4%, ndërsa për vitin 2022 është 11.6%.

Paditësin F.J.

Nga kontrata e punës e lidhur ne mes paditësit dhe te paditurës vërtetohet fakti se paditësi ka filluar punën me datën 01.09.2015 tek e paditura.
Nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar page mujore ne lartësi prej 283.01 euro, kurse kompensimine e ka kërkuar për pagën prej 241.68 euro. Ndërsa nga indeksi i harmonizuar çmimeve te konsumit konstatohen ndryshimet mujore dhe vjetore te çmimeve ne përqindje: inflacioni për vitin 2019 është 2.7, për vitin 2020 është 0.2%, për vitin 2021 është 3.4%, ndërsa për vitin 2022 është 11.6%.

Paditësen F.A.

Nga kontrata e punës e lidhur ne mes paditësit dhe te padituës vërtetohet fakti se paditësi ka filluar punën me datën 02.11.2020 tek e paditura.
Nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar page mujore ne lartësi prej 530.07 euro kurse kompensimin e ka kërkuar për pagën 487.84 euro. Ndërsa nga indeksi i harmonizuar çmimeve te konsumit konstatohen ndryshimet mujore dhe vjetore te çmimeve ne përqindje: inflacioni për vitin 2019 është 2.7, për vitin 2020 është 0.2%, për vitin 2021 është 3.4%, ndërsa për vitin 2022 është 11.6%.

Paditësin J.K.

Nga kontrata e punës e lidhur ne mes paditësit dhe te padituës vërtetohet fakti se paditësi ka filluar punën me datën 01.12.2018 tek e paditura.
Nga lista e pagës vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar page mujore ne lartësi prej 363.58 euro kurse kompensimin e ka kërkuar për 272.84 euro. Ndërsa nga indeksi i harmonizuar çmimeve te konsumit konstatohen ndryshimet mujore dhe vjetore te çmimeve ne përqindje: inflacioni për vitin 2019 është 2.7, për vitin 2020 është 0.2%, për vitin 2021 është 3.4%, ndërsa për vitin 2022 është 11.6%.

Në padi është ngritur pretendimi se paditësit nuk kane pranuar kompensimin e shtesave ne page-inflacion për vitet 2018,2019,2020,2021 dhe 2022 pasi qe mbështetje te nenin 35 par 10 te KKAK te parashihet qe "Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë". Nga interpretimi i kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e njëjta dispozitë është detyruese për të padituën andaj edhe e ka detyruar të njëjtën që pjesërisht paditësve ti kompensoj kërkesat lidhur me kompensimin e shtesave ne page-inflacionit për periudhën kohore të cekur ne piken I te dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku në nenin 35 është paraparë e drejta punëtoreve të arsimit ne kompensim në emër të shtesave ne page-inflacion, si dhe gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datë 18.04.2017. Pas skadimit të kësaj kontrate, është nxjerrë kontrata e re, me datën 21.04.2021 e cila i'u garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit pjesërisht aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit "*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë".* Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësve për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensimin e shtesave ne page-inflacionit e njëjta është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësit e kane rolin e kreditorit, kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: *"Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij".*

Gjykata, pretendimet e të padituës të ngritura përmes përgjigjes në padi se kërkesa e paditësve për kompensimin e inflacionit ne page është parashkruar për periudhën 2017, 2018 dhe 2019

pasi qe paditësit kanë paraqitur padinë me datën 16.08.2022 për gjykatën ky pretendim është pjesërisht i bazuar dhe e njëjta ka refuzuar kërkesën e paditësve për periudhën kohore nga 01.01.2018 e deri me datën 15.08.2019 pasi qe kjo periudhe është parashkruar ne baze te nenit 87 te Ligjit te Punës parashihet *"Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës",* andaj ne baze te kësaj gjykata ka refuzuar kërkesën e paditësve si ne piken II te dispozitivit te këtij aktgjykimi pasi qe kërkesat për periudhën e lartcekur janë parashkruar.

Ndërsa lidhur me pretendimet e te paditurës te dhëna ne përgjigjen ne padi, gjykata ka konstatuar se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë fare për faktin se sa i përket pretendimit se Ministria e Arsimit e ka shkëputur në mënyrë të njëanshme Kontratën Kolektive të Arsimit me datën 21.11.2022 gjykata ka konstatuar se te gjitha kërkesat e arritura para datës se shkëputjes se njëanshme nga ana e te paditurës janë te realizueshme dhe se e paditura është e obliguar që të bëje kompensimin e kërkesës se paditësve te vendosur si ne piken I te dispozitivit.

Gjykata vendosi si ne piken I.1 dhe I.4 te dispozitivit sa i përket paditësit E.S duke e aprovuar kërkesën për periudhën kohore 01.09.2021 deri 22.11.2022 dhe për paditësen F.A. për periudhën kohore prej 02.11.2020 deri 22.11.2022, duke marr parasysh faktin se për këtë periudhë e kanë dëshmuar me prova se kanë qenë te punësuar tek e paditura.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi ne piken I te dispozitivit e ne mbështetje të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit "Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e llogaritur nga dita e paraqitjes se padisë te datës 16.08.2022.

Ndërsa sa i parket kërkesave nga data 23.11.2022 e deri me 31.12.2022 gjykata ka vendosur si ne piken II te dispozitivit duke refuzuar kërkesat për kompensimin e inflacionit pasi qe janë kërkesa qe përfshihet ne periudhën kohore kur Kontrata Kolektive e Arsimit është shkëputur një anshëm nga e Ministrisë e Financave dhe si e tille nuk ka bazë ligjore qe te kërkohet kompensim për periudhën e lartcekur e po ashtu duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme nr.214/2023 te dt. 09.10.2023.

Ne kuptim te nenit 399 par 1 te LPK parashihet q *"* kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia".

Gjykata ne mbështetje te nenit 452 të LPK-së vendosi si në dispozitivin e pike II të këtij aktgjykimi, ashtu që detyrohet e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 312.00€- sipas tarifës së OAK.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 8,398, 399 dhe 452 të LPK-së, e në lidhje më dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit e datës:22.01.2021, dhe asaj te vitit 2017, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 parg.1 dhe 2 të LMD-së si dhe konform Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme nr.214/2023 te dt. 09.10.2023.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshmen-Divizioni civil
C.nr1305/2022, datë 31.01.2024

Gjyqtari
Blerim Istrefi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.